



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 159 prot.

Tiranë, më 28. 05. 2024

V E N D I M

Nr. 159, datë 28. 05. 2024

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi¹”, i ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi² mori në shqyrtim ankesën me nr. 106 Regj., datë 21.05.2024, paraqitur nga shtetasja D. A., kundër Institutit të Sigurimeve Shoqërore, me pretendimin për diskriminim, për shkak të *përgjegjësia prindërore*³ dhe *aftësia e kufizuar*⁴.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon Komisionerin, se: “ *...jam nënë e 2 fëmijëve me aftësi të kufizuara. Vajza 17 vjeç është me a.... dhe d....., ndërsa djali 7 vjeç me p.... c.... s....., e..... dhe probleme në z..... Djali është operuar në 25 mars 2024 tek të dyja kavigjethet e këmbëve. Deri tani kam marrë 2 muaj raport mjekësor për djalin nga Spitali Amerikan 3, nga mjeku L. F. dhe jam paguar 1 muaj e 35 ditë. Jam paraqitur tek ambulanca e lagjes për të marrë me shumë ditë raport për djalin dhe doktoresha më thotë që duhet të paraqitesh tek ortopedi në ambulancën e madhe, aty më thotë doktori që me dëshirën më të madhe për të të ndihmuar dhe duke e ditur problematikën e djalit duhet të shkosh një herë tek sigurimet sepse më duket që nuk të paguhet më raporti më i gjatë. Shkoj tek sigurimet dhe aty më thonë që vetëm personave që operohen jashtë shtetit i jepet raport më i gjatë për të mos humbur vendin e punës, ne zbatojmë*

¹ Në vijim do t’i referohemi me akronimin LMD.

² Në vijim do t’i referohemi me akronimin KMD ose Komisioneri.

³ Referuar Certifikatës Familjare datë 21.05.2024, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë Administrative Nr. 8, Tiranë, ankuesja është nënë, kryefamiljare.

⁴ Referuar dokumenteve mjekësor të dorëzuar në cilësinë e provës, rezulton se ankuesja ka 2 fëmijë me aftësi të kufizuara.

rregulloren dhe ligjin. Unë punoj sanitare në çerdhen 23, Tiranë. Raporti më duhet për të justifikuar mos paraqitjen në punë sepse djali ka nevojë akoma për shërbimin tim. Në datë 24 maj unë duhet të rikthehem në punë. Bashkëshorti ka ndërruar jetë para një viti dhe banesën që jetonim bashkë me prindërit e bashkëshortit ma mori kunata bashkë me vjehrrën. Kam ikur të jetoj tek prindërit e mi, në një apartament në katin e pestë, aty e kam problem sepse djali është me karrocë invaliditeti dhe është e pamundur të hipi me djalin në krah deri në katin e pestë. Kam aplikuar tek Bashkia e Tiranës për bonus qiraje që në dhjetor 2023 dhe akoma skam marrë asnjë përgjigje”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të konstatojë diskriminimin e saj nga ana a Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të shihet mundësia për të ndryshuar ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, për të tilla raste ku nënat kanë nevojë të kujdesen për fëmijët e tyre me aftësi të kufizuara.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në nenin 3/1, të LMD parashikohet se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Neni 7/1 i LMD-së⁵, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Në Kreun IV, të LMD-së parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. LMD në nenin 20/1/a dhe b⁶, ndalon çdo lloj dallimi, kufizimi ose përjashtimi, që i bëhet një personi apo grupi personash në ofrimin e të mirave dhe shërbimeve.

⁵ Shkurtesë për Ligjin “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

⁶ Neni 20/1/a dhe b, të ligjit nr. 10221/2010: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

Në vijim, subjekti ankues, nëpërmjet e-mail-it të datës 27.05.2024, të dërguar në adresën e KMD-së, ka kërkuar të tërhiqet nga ankesa, pasi nga ana e subjektit kundrejt të cilit ka paraqitur ankesën pranë KMD-së, është mundësuar pagesa e detyrimeve të prapambetura nga ana e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, dhe konsideron që tashmë nuk ka arsye për të vijuar më tej me trajtimin e saj.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr.10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Në nenin 94⁷/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”.

Procedura administrative konkrete pranë Komisionerit, është iniciuar mbi bazën e ankesës së paraqitur nga subjekti ankues, D. A., e cila, me anë të e-mailit të datës 27.05.2024, është tërhequr nga ankesa e saj pranë KMD-së.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, si dhe kërkesën për tërheqje nga ankesa të paraqitur nga ankuesja në datën 27.05.2024, Komisioneri vlerëson se, procedura për shqyrtimin e ankesës me nr. 106 regj., datë 21.05.2024, të paraqitur nga ankuesja D. A., nuk mund të vazhdojë, por duhet të deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti ankues është tërhequr

japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi...”

⁷ “Tërheqja e ankesës”.

nga ankesa dhe nuk identifikohet ndonjë interes publik që do të legjitimonte vazhdimin e procedurës, nga ana e këtij organi publik⁸.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 32, pika 1, shkronja “a” dhe nenin 33, pika 1, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës me nr. 106 Regj., datë 24.05.2024, të D. A., për shkak se subjekti ankues është tërhequr nga ankesa pranë KMD-së.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Përgjegjësia prindërore dhe aftësia e kufizuar)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)

⁸ Për analogji citojmë: Vendimin nr. 230, datë 07.11.2023, Vendimin nr. 104, datë 22.04.2024, të KMD-së.